



Сектор за пензиско и инвалидско
осигурување

Sektori për sigurim invalidor dhe
pensional

THIRRJE PUBLIKE

për pjesëmarrje në punën e Komisionit për revizionin e konstatimit, vlerësimit dhe mendimit për përcaktimin e invaliditetit, gjegjësisht paaftësisë për punë

Ministria e Politikës Sociale, Demografisë dhe Rinisë, në pajtim me nenin 3 të Rregullores për organizimin, përbërjen dhe mënyrën e punës së Komisionit për revizionin e konstatimit, vlerësimit dhe mendimit për përcaktimin e invaliditetit, gjegjësisht paaftësisë për punë ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 2 /13, 13/16 dhe 2/19 dhe "Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr. 318/20 dhe 273/22), në tekstin e mëtejme Komisioni i revizionit, i fton mjekët e interesuar - specialistët të paraqiten për pjesëmarrje në punën e Komisionit për revizion për periudhë prej një viti.

Në këtë thirrje mund të paraqiten persona të shquar mjekësorë që punojnë në institucionet shëndetësore dhe që kanë të paktën 5 vjet përvojë pune pas dhënies së provimit specialistik në fushën e mëposhtme:

- specialist në mjekësinë e punës,

Personat e interesuar për të marrë pjesë në punën e Komisionit për revizion duhet të dorëzojnë:

- Kërkesë për pjesëmarrje në punën e Komisionit për revizion,
- biografi e shkurtër,
- kopjen e licencës së punës,
- vërtetim për marrëdhënien e punës, dhe
- kopje të vërtetimit për dhënien e provimit të specializuar, si dëshmi e përvojës së punës në fushë, të paktën 5 vite pas specializimit.

Kërkesa së bashku me dokumentacionin e nevojshëm dorëzohet në Ministrinë e Politikës Sociale, Demografisë dhe Rinisë, rr. "Dame Gruev", nr. 14, 1000 Shkup, në zarf të mbyllur me shënimin: THIRRJE PUBLIKE – Komisioni për revizion - MOS E HAP, më së voni deri më 27.06.2026

MINISTRIA E POLITIKËS SOCIALE, DEMOGRAFISË DHE RINISË